





Strategjia e Zhvillimit 2025-2029



DIVERSIFIKIMI
SI NXITËS PËR
PROFESIONIT

DHE INOVACIONI
ZHVILLIM TË



PËRMBAJTJA

HYRJE	02
MISIONI, VIZIONI DHE QËLLIMET.....	03
VLERAT.....	04
ANALIZA MJEDISORE	05
ANALIZA SWOT.....	07
SHTYLLAT STRATEGJIKE.....	08
PROFESION I QËNDRUESHËM DHE ATRAKTIV PËRMES- EDUKIMIT PROFESIONAL	09
GJITHËPËRFSHIRJA DHE MBËSHTETJA E ANËTARËVE PËR ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM PROFESIONAL.....	12
QEVERISJA E MIRË.....	14
PËRFUNDIM.....	17




HYRJE

Ky dokument paraqet Strategjinë e ShKÇAK për periudhën 2025 – 2029 dhe është përpiluar duke u bazuar në misionin dhe vizionin e saj, ndikimin në shoqëri, ambientin në të cilin vepron dhe trendet e fundit që ndikojnë në profesionin e kontabilitetit dhe auditimit.

Strategjia paraprake e ShKÇAK për periudhën 2020-2024 e cila është realizuar plotësisht, ka pasur në fokus Zhvillimin e profesionistëve të së ardhmes, ofrimin e vlerës për anëtarët si dhe themelimin e qendrës së ekselencës për zhvillim. Me arritjen e objektivave të strategjisë paraprake, synimi i ShKÇAK për periudhën e ardhshme pesë vjeçare është të përqendrohet në rritjen e ndikimit dhe rolit të saj si një lider profesional duke zbatuar një strategji të bazuar në diversitet dhe inovacion.

ShKÇAK synon të mbështesë zhvillimin e aftësive të anëtarëve përmes ofrimit të programeve të avancuara të trajnimit dhe certifikimit, të cilat përputhen me standardet ndërkombëtare dhe kërkesat e reja të tregut, veçanërisht në fushat e teknologjisë dhe raportimit të qëndrueshmërisë (ESG). Duke përqafuar teknologjinë dhe përmirësuar kapacitetet për të adresuar sfidat e raportimit të qëndrueshmërisë dhe qeverisjes korporative, ShKÇAK do të ndihmojë profesionistët të përshtaten dhe të japin kontribut të vlefshëm në një mjedis gjithnjë e më kompleks dhe të ndërlikur. Gjithashtu, ShKÇAK do të punojë për të forcuar bashkëpunimin me institucionet kombëtare dhe ndërkombëtare, do të zhvillojë kapacitetet për të përmbushur Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG) dhe do të përmirësojë reputacionin e saj përmes angazhimit aktiv në promovimin e integritetit dhe transparencës. Me këtë strategji, ShKÇAK synon të rrisë përfshirjen e gjeneratave të reja dhe të promovojë një mjedis gjithëpërfshirës dhe të barabartë për të gjithë profesionistët e kontabilitetit dhe auditimit në Kosovë.



MISIONI, VIZIONI DHE QËLLIMI

MISIONI

Misioni ynë si organizatë profesionale e Kontabilitetit dhe Auditimit është t'i shërbejë interesit publik përmes ofrimit të profesionistëve të kualifikuar që ofrojnë standardet më të larta ndërkombëtare të ekspertizës dhe integritetit.

VIZIONI

Shoqatë lidere në avancimin e profesionit të kontabilitetit, auditimit dhe shërbimeve tjera të specializuara duke ofruar gjithmonë zgjedhjen më të mirë për profesionistët

QËLLIMI

Qëllimi i përgjithshëm i ShKÇAK është të punojë në interes të publikut për të promovuar standarde të larta dhe për të ofruar përsosmëri në kontabilitet, auditim, qeverisje dhe menaxhim financiar në të gjithë sektorët e ekonomisë në Kosovë.



VLERAT

Integriteti: Ne jemi të përgjegjshëm dhe presim të njëjtën gjë nga të tjerët, veprojmë në interes dhe fokus publik mbi vlerat afatgjate.

Transparenca: Ne veprojmë me transparencë, duke siguruar qasje të barabartë në informacion dhe vendimmarrje të qartë për të gjithë.



Etika: Ne mbështetemi në standarde të larta etike, duke udhëhequr me përgjegjësi dhe përkushtim ndaj parimeve profesionale.

Gjithpërfshirja: Ne krijojmë mundësi për të gjithë, largojmë barrierat, krijojmë lidhjet dhe përqafojmë diversitetin.

Inovacioni: Mendojmë dhe ecim përpara. Ne eksplorojmë ide të reja, duke krijuar zgjidhje që i sigurojnë komunitetit tonë dhe profesionit të jenë të gatshëm sot dhe nesër.

integriteti

etika



transparenca

gjithpërfshirja

inovacioni



ANALIZA MJEDISORE

ShKÇAK ka analizuar me kujdes mjedisin e jashtëm dhe të brendshëm, duke marrë parasysh sfidat, mundësitë dhe nevojat e komunitetit profesional që ajo përfaqëson. Ky proces ka përfshirë vlerësimin e faktorëve ekonomikë, shoqërorë, teknologjikë, ligjvënës dhe profesional që ndikojnë drejtpërdrejt në funksionimin dhe misionin e organizatës.

Kërkesa për aftësi të avancuara dhe të specializuara:

Në një ekonomi globale të bazuar gjithnjë e më shumë në teknologji dhe inovacion, profesionistët e kontabilitetit dhe auditimit përballen me kërkesa të reja për njohuri në fusha si intelijenca artificiale, analiza e të dhënave, dhe teknologjitë blockchain.

Ndryshimet demografike dhe shoqërore:

Gjeneratat e reja kërkojnë mënyra fleksibile dhe interaktive të mësimin, duke i bërë të domosdoshme modelet hibride dhe trajnimet online.

Nevoja për gjithpërfshirje dhe diversitet:

Profesioni i kontabilitetit dhe auditimit po bëhet gjithnjë e më shumë gjithpërfshirës, duke u bazuar në kërkesën në rritje, moshë, gjinia, komunitetet dhe profesionet.

Mundësia e lidhjes mes edukimit dhe tregut të punës:

Studentët dhe profesionistët e rinj shpesh hasin vështirësi në kalimin nga edukimi në punësim, duke kërkuar zgjidhje për rrjetëzim profesional dhe mbështetje për avancim në karrierë.

Kërkesa e lartë për talentët:

Tregu kërkon gjithnjë e më shumë aftësi të avancuara, duke nxitur domosdoshmërinë për mentorim dhe zhvillim profesional të vazhdueshëm.



ANALIZA MJEDISORE

Transparencë dhe besueshmëri:


Besimi në institucionet dhe organizatat profesionale është bërë një faktor i rëndësishëm, duke zbatuar kërkesën për qeverisje të mirë dhe raportim transparent.

Ndryshimet në legjislacion dhe rregullore:

Mjedisi ligjor dhe rregullator i Kosovës dhe rajonit po përjeton zhvillime të vazhdueshme që kërkojnë përshtatje dhe avokim të vazhdueshëm për mbrojtjen e interesit publik.

Promovimi i përgjegjësisë mjedisore, sociale dhe qeverisëse:

Çdo ditë e më tepër po kërkohet nga Organizatat profesionale të luajn një rol më të madh në promovimin e qëndrueshmërisë dhe përgjegjësisë mjedisore, sociale dhe qeverisëse, duke krijuar nevojën për një udhëheqje të qëndrueshme dhe transparente.



ANALIZA SWOT

PËRPARËSITË

- Lider në treg
- Njohje globale - anëtare e plotë në IFAC, FCM dhe EFAA
- Staf profesional dhe të motivuar
- Qeverisje e mirë
- Reputacion i lartë
- Bashkëpunimi me palët e interesit
- Cilësia e shërbimeve të ofruara

DOBËSITË

- Qëndrueshmëria financiare nga të hyrat e anëtarësisë
- Sfida e rekrutimit të stafit të ri

Analiza SWOT

MUNDËSITË


- Zhvillimi i kapaciteteve në sektorin publik
- Zhvillimi specializimeve / certifikimeve të tjera
- Nevoja e tregut të punës për profesionsitë
- Qendër për ekselencë

RREZIQET

- Korniza ligjore
- Ambienti i përgjithshëm - mosfunksionimi/moszbatimi i ligjit
- Konkurrenca jo lojale
- Kthimi i investimit të programeve të reja
- Migrimi i të rinjëve

OBJEKTIVAT STRATEGJIKE

Objektivat strategjike janë elemente kryesore që ShKÇAK përdor për të strukturuar dhe udhëhequr strategjinë e saj të përgjithshme, duke siguruar që të arrijë qëllimet e saj afatgjata. Për të arritur këtë, strategjia jonë e ardhshme fokusohet në tre shtylla:



1. PROFESION I QËNDRUESHËM DHE ATRAKTIV PËRMES EDUKIMIT PROFESIONAL

1.1 Diversifikimi i shërbimeve

Në përmbushjen e misionit për të ofruar një profesion të qëndrueshëm dhe tërheqës, ShKÇAK synon diversifikimin e shërbimeve të tij përmes trajnimeve të specializuara që adresojnë nevojat e ndryshme të profesionistëve. Këto trajnime synojnë:


- **Shtigje të reja karriere:** Ofrojnë një gamë të gjerë mundësish për profesionistët që të ndjekin fusha specifike relevante për profesionin.
- **Trajnime të avancuara në:**
 - Financa dhe kontabilitet për menaxherët financiarë dhe jo-financiarë.
 - Raportim financiar dhe raportim të integruar.
 - Inovacion digjital, analizë e të dhënave dhe inteligjencë artificiale.
 - Teknologjitë e reja si blockchain dhe qëndrueshmëria financiare.
- **Platformë online profesionale:** Një rrjet i dedikuar për profesionistët që të marrin certifikime të specializuara në fusha të ndryshme, duke u përshtatur me kërkesat dhe trendet e tregut aktual.

1.2 Avancimi dhe modernizimi i kurrikulës

ShKÇAK synon një qasje gjithëpërfshirëse dhe të avancuar në përmirësimin e kurrikulës:

- **Rishikimi dhe përditësimi i vazhdueshëm:** Kurrikulat pasqyrojnë trendet më të fundit të industrisë, zhvillimet teknologjike dhe ndryshimet rregullatore.
- **Adaptimi i standardeve ndërkombëtare:** Përfshirja e standardeve më të reja të kontabilitetit dhe auditimit dhe standarde të tjera ndërkombëtare për të përgatitur profesionistët për tregun global.
- **Zhvillimi i aftësive praktike dhe të qëndrueshme:** Kurrikulat fokusohen në zhvillimin e aftësive të dobishme që adresojnë sfidat dhe mundësitë në botën reale.

8 PROGRAME SPECIALIZUESE SIPAS STRATEGJISË 2025-2029



1.3 Edukimi i Vazhdueshëm Profesional (EVP)

Për të ruajtur një profesion dinamik dhe të përditësuar, ShKÇAK ofron një gamë të gjerë mundësish për edukim të vazhdueshëm profesional:

- **Tema relevante dhe praktike:** Trajnime që mbajnë profesionistët të përditësuar me ndryshimet më të fundit në fusha të ndryshme të profesionit.
- **Platforma online:** Organizimi i seminareve online përmes platformave si Zoom, duke siguruar qasje të lehtë dhe fleksibilitet për të gjithë pjesëmarrësit.
- **Qasje në materiale:** Materiale profesionale që lehtësojnë procesin e zhvillimit të vazhdueshëm profesional.
- Qasje në EVP të ofruar nga Organizatat ndërkombëtare ku jemi anëtarë.

1.4 Modelet fleksibël të mësimi

Për të plotësuar nevojat e profesionistëve dhe studentëve, të ofrohen metoda fleksibile të mësimi:

- **Trajnime online me cilësi të lartë:** Sigurohet që pjesëmarrësit të kenë qasje në materiale të avancuara, angazhim të barabartë dhe mundësi për të përfituar certifikata në kohën dhe mënyrën që i'u përshtatet.
- **Programe të përshtatura për grupe:** Institucionet dhe grupet e profesionistëve kanë mundësinë të kualifikohen ose të përmirësojnë njohuritë e tyre duke ndjekur programe të dizajnuara sipas kërkesave të tyre.

ShKÇAK përmes *Shtyllës 1* të kësaj Strategjie synon të ndërtoj një mjedis të përshtatshëm për profesionistët e sotëm dhe të ardhshëm, duke kontribuar në zhvillimin e një profesioni të fortë dhe të qëndrueshëm që përmbush standardet më të larta profesionale.

2. GJITHËPËRFSHIRJA DHE MBËSHTETJA E ANËTARËVE PËR ZHVILLIMTË QËNDRUESHËM PROFESIONAL

ShKÇAK përmes kësaj strategjie do të ofrojë qasje gjithëpërfshirëse si shtyllë kyçe për të përforcuar pozicionin strategjik si një lider në fushën e kontabilitetit dhe auditimit në vend. ShKÇAK angazhohet të ofrojë një platformë gjithëpërfshirëse për të gjithë individët, organizatat, bizneset, institucionet dhe komunitetet, ku të gjithë do të gëzojnë mbështetje të vazhdueshme.

2.1 Angazhimi për cilësi dhe relevancë profesionale

- **Pajtueshmëria me standardet profesionale:** ShKÇAK vazhdon të mbrojë dhe promovojë rëndësinë e profesionit të kontabilitetit dhe auditimit, duke impleментuar një sistem të Menaxhimit të Cilësisë.
- **Fuqizimi i profesionistëve:** Anëtarët e ShKÇAK janë të pajisur me aftësi praktike dhe teknike që shtojnë vlerë në vendet e tyre të punës, duke ndikuar në suksesin dhe qëndrueshmërinë e organizatave ku ata kontribuojnë.


2.2 Shërbimet e mbështetjes dhe karrierës për antarët dhe studentët

- **Ndërtimi i urave midis brezave:** ShKÇAK do të krijojë ura bashkëpunimi ndërmjet studentëve dhe profesionistëve me përvojë në fushën e kontabilitetit dhe auditimit. Këto bashkëpunime do të ndihmojnë studentët të eksplorojnë rrugë të ndryshme karriere dhe të mësojnë nga përvoja e kolegëve të tyre.
- **Platforma për rrjetëzim dhe punësim:** Do të zhvillohet një platformë profesionale për rrjetëzim që ndihmon anëtarët dhe studentët të lidhen me punëdhënësit dhe kolegët, duke lehtësuar gjetjen e vendeve të punës dhe duke u siguruar të rinjve një fillim të suksesshëm në karrierën e tyre.
- **Mbështetje për arritje në karrierë:** ShKÇAK do të ofrojë mbështetje të vazhdueshme për të gjithë anëtarët, përfshirë këshilla profesionale, mentorim dhe orientim karriere për ata që sapo kanë filluar ose dëshirojnë të avancojnë në karrierën e tyre.

2.3 Mbështetje për të gjithë dhe qasje gjithëpërfshirëse

- **Përfshirja e anëtarëve në të gjitha nivelet:** Që nga studentët e rinj deri te profesionistët me përvojë, të gjithë gëzojnë qasje të barabartë në shërbimet e mbështetjes dhe mundësitë për zhvillim.
- **Mbështetje për individët dhe organizatat:** ShKÇAK angazhohet të mbështesë jo vetëm individët që i bashkohen organizatës, por edhe ata që tashmë janë anëtarë aktiv, duke siguruar që të përfitojnë nga mundësitë që ofrohen për të qëndruar relevantë dhe konkurrues.
- **Adaptimi ndaj ndryshimeve:** Duke ndjekur një qasje të hapur dhe fleksibile, ShKÇAK ndihmon anëtarët të përfitojnë nga ndryshimet teknologjike dhe zhvillimet e reja, duke i fuqizuar ata për të qenë në krye të profesionit të tyre.

Përmes *Shtyllës 2*, ShKÇAK mbetet e përkushtuar për të mbështetur dhe fuqizuar anëtarët e saj, duke siguruar që ata të jenë të gatshëm për të adresuar sfidat e sotme dhe për të ndërtuar një karrierë të qëndrueshme në të ardhmen.



3. QEVERISA E MIRË

Reputacioni dhe ndikimi i ShKÇAK përfaqësojnë një shtyllë të rëndësishme strategjike, duke pozicionuar organizatën si një lider të besueshëm dhe të respektuar në fushën e kontabilitetit dhe auditimit. Përmes udhëheqjes së bazuar në transparencë dhe qeverisje të mirë, ShKÇAK synon të krijojë një kulturë që promovon përgjegjësi, integritet dhe besueshmëri në aktivitetet e saj.

3.1 Qeverisja e mirë si themel i suksesit

Qeverisja e mirë është një komponent thelbësor i strategjisë së ShKÇAK për të siguruar efikasitetin dhe efektivitetin e organizatës.

- **Rishikimi i vazhdueshëm i rregulloreve dhe strukturave:** Statuti, rregulloret e punës dhe struktura organizative do të avancohen vazhdimisht për të adresuar ndryshimet në mjedisin profesional dhe për të pasqyruar diversitetin dhe nevojat e anëtarësisë.
- **Integrimi i diversitetit:** Përfshirja e të gjitha grupeve të interesit, pavarësisht përvojës, fushës së veprimtarisë, duke siguruar që ShKÇAK të përfaqësojë me dinjitet interesat e një komuniteti të gjerë profesionistësh.

3.2 Udhëheqja me transparencë dhe integritet

- **Angazhimi për transparencë:** ShKÇAK zbaton praktika të qarta dhe të hapura në proceset e saj vendimmarrëse, duke rritur besimin e anëtarëve dhe palëve të interesit.
- **Raportimi i rregullt:** Sigurimi i informacionit të qartë dhe të plotë për anëtarët dhe partnerët mbi aktivitetet e organizatës, duke forcuar besimin dhe bashkëpunimin.
- **Etika si udhërrëfyes:** Çdo veprim dhe vendim i ShKÇAK udhëhiqet nga standardet më të larta etike, duke u siguruar që të gjitha aktivitetet të jenë në përputhje me parimet e përgjegjësisë dhe integritetit.


3.3 Organizatë e qëndrueshme dhe e besueshme

- **Forcimi i kapaciteteve organizative:** Përdorimi i teknologjive moderne dhe inovacionit për të siguruar që SHKÇAK të mbetet një organizatë lider në tregun dinamik të kontabilitetit dhe auditimit.
- **Promovimi i përfshirjes dhe bashkëpunimit:** Organizimi i aktiviteteve që nxisin bashkëpunimin midis anëtarëve, institucioneve dhe partnerëve ndërkombëtarë për të ndarë praktikat më të mira dhe për të forcuar pozicionin e organizatës.


3.4 Avokimi për përmirësim të rregullativës ligjore

ShKÇAK luan një rol aktiv në mbështetjen dhe avancimin e rregullativës ligjore në fushën e kontabilitetit dhe auditimit, duke u fokusuar në krijimin e një sistemipërmes zhvillimit të komisioneve të saj që mbështetë qëndrueshmërinë dhe përgjegjësinë:

- **Zëri i profesionistëve:** Përfaqësimi i interesave të anëtarëve dhe komunitetit të gjerë të profesionistëve përmes dialogut konstruktiv me institucionet vendore dhe ndërkombëtare.
- **Avokim në avancimin e rregullativës ligjore:** ShKÇAK do të angazhohet në avokimin për avancimin e rregullativës ligjore për të siguruar që ato përfaqësojnë interesat dhe prioritetet e profesionit.



Duke u udhëhequr nga parimet e qeverisjes së mirë dhe transparencës, përmes Shtyllës 3, ShKÇAK synon të qëndrojë si lider i profesionit të kontabilitetit dhe auditimit në vend, duke frymëzuar anëtarët dhe partnerët të ndjekin standardet më të larta të etikës dhe qëndrueshmërisë. Kjo qasje ndihmon në ndërtimin e një komuniteti të fortë, të përkushtuar dhe të besueshëm, i cili krijon vlerë të qëndrueshme për të gjitha palët e interesit dhe kontribuon në zhvillimin e vazhdueshëm të profesionit dhe ekonomisë.



PËRFUNDIM

Strategjia e ShKÇAK për periudhën 2025-2029 është një vizion ambicioz dhe gjithëpërfshirës që synon avancimin e profesionit të kontabilitetit dhe auditimit në Kosovë. Me fokus në diversifikim dhe inovacion, strategjia përqendrohet në përmirësimin e aftësive të anëtarëve, adresimin e sfidave të reja si teknologjia dhe raportimi i qëndrueshmërisë, dhe përmbushjen e standardeve ndërkombëtare. Ajo pasqyron angazhimin e ShKÇAK për të përmbushur nevojat e anëtarëve të saj, për të kontribuar në zhvillimin ekonomik të vendit dhe për të forcuar reputacionin e organizatës si një lider profesional dhe etik.

Me këtë qasje strategjike, ShKÇAK afirmon rolin e saj si një shtyllë kyçe në zhvillimin e profesionit dhe fuqizimin e profesionistëve në një mjedis gjithnjë e më kompleks. Strategjia adreson gjithashtu nevojën për përfshirje, transparencë dhe qeverisje të mirë, duke siguruar që organizata të vazhdojë të jetë një model i qëndrueshmërisë dhe inovacionit për sektorin profesional në Kosovë dhe më gjerë. Kjo përpjekje do të ndihmojë ShKÇAK të arrijë qëllimin e saj për të mbetur një organizatë e besueshme dhe e respektuar, duke ofruar vlerë të qëndrueshme për të gjitha palët e interesit

